



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:033165  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05640836

C.nr.307/20

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve I.K. etj, nga fshati Q., Komuna Pejë, të cilët i përfaqëson Blerim Ademaj, avokat nga Peja, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, Rr. Demokracia, nr.20, me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seance me datën 30.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditësve I.K. etj, nga fshati Q., Komuna Pejë, e parashtruar me datë 03.03.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësit I.K. etj, nga fshati Q., Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”- Prishtinë me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro.

Gjykata, me datën 28.03.2024, ka pranuar parashtrësën e paditësve, përkatësisht të paraqitur përmes të autorizuarit të tyre, me anë të së cilës parashtrësë, i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se të njëjtit kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore me këtu të paditurën. Gjykata të paditurën e ka njoftuar me parashtrësën mbi tërheqjen e padisë së paditësve, të cilën e ka pranuar me datën 02.04.2024, mirëpo e njëjta nuk është deklaruar lidhur me të.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë*

*të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.*

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.307/20, me datë 30.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.